

GJEODETI **SURVEYORS**

Botim i Shoqatës së Gjeodetëve të Shqipërisë



MARKAT

Shenjat dalluese

Topogarafiko-Gjeodezike

Çfarë është ALBPOS

Fjala e Presidentit të CLGE

Jean-Yves Pirlot

22 Janar Dita e Gjeodetit

Konferenca e Parë Young Surveyors

Janar 2012

Maksimizoni produktivitetin e punes tunj me teknologjine BLE!



Kompania Amerikane TRIMBLE,
Lider Boteror ne prodhimin e Marresave GPS-GNSS,
ofron teknologjine me te fundit ne fushen e gjeodezise,
pozicionimit global si dhe skanimit tri-dimensional.
Produktet Trimble,
jane mjaft te thjeshte ne perdorim, jane te nje cilesie
absolute, si dhe nje saktetesi mjaft te larte.

Nder familjet e produkteve Trimble jane:

- Skanera Laser 3D
- Sisteme GPS-GNSS
(GPS dore GeoXR, GPS R4, GPS-GNSS R5, GPS-GNSS R6, GPS-GNSS R7, GPS-GNSS R8)
- Stacione Totale, te Geodimeter
(Suedez)
(Mekanik M3, Servo, Autolock & Robotik S3, S6, S8) me saktetesi 0.5"-5"
- Nivela Digitale
(Dini 0.7 & 0.3 mm)



GEOTRIM shpk

Ofron per te gjithë :

- Kurse trajnimi per perdorimin e instrumentave, si ne zyre ashtu dhe ne teren.
- Asistence teknike,
- Mirembajtje dhe
- Kolaudim
- Update dhe Upgrade
- Pune dhe sherbime
(Rilevim, piketim, projektim, matje etj)
- Instrumenta dhe paisje me Qera
- Lehtesira per Gjeodetet e rinj dhe studentet!

Total Station, GPS, Nivela

Me Qera

Geotrim shpk

Adresa: Rr. Lord Bajron, Vila Nr.1,
Tel: +355682055616



Geotrim,
krijuar per t'ju sherbyer!

GEOTRIM

SURVEYING ~ CONSTRUCTION ~ NIKON-TRIMBLE

Adresa: Rr. Lord Bajron, Vila Nr.1,
(Kryqezimi kryesor i Laprakes)
Laprake, Tirane,

Tel: +35542257548, Mob: +355682055616

E-mail: geotrim.al@gmail.com ; contact@geotrim.al

Web: www.geotrim.al ; www.trimble.com



Stacione Totale
Autonivela
Nivela Dixhitale
Programe perpunimi te dhenash



Programet e perpunimit te te dhenave ne terren dhe ne zyre,

- Te fjales se fundit te informatikes
- Cdo dite e me dinamike
- Lehtesi ne Pune



Total Station, GPS, Nivela

Me Qera

Geotrim shpk

Adresa: Rr. Lord Bajron, Vila Nr.1,

Tel: +355682055616



Spectra Survey PRO Trimble Digital Fieldbook

Trimble Survey Controller

GEOTRIM

SURVEYING ~ CONSTRUCTION ~ NIKON-TRIMBLE

Adresa: Rr. Lord Bajron, Vila Nr.1,
(Kryqezimi kryesor I Laprakes)
Laprake, Tirane,

Tel: +35542257548, Mob: +355682055616
E-mail: geotrim.al@gmail.com ; contact@geotrim.al
Web: www.geotrim.al ; www.trimble.com

AGJENSIA ALBINFO

Kliko:
www.albinfo.al
www.albania-map.com

GJEJ:

HOTELE BARE RESTORANTE PLAZHE
EMER RRUGE INSTITUCIONE KOMPANI
PARK NATYROR KALA PARK ARKEOLOGJIK
PRONA - APARTAMENTE - DYQANE - TOKA

Real Estate
7438
Percakto kontonin Resultatet(t)
Informacion Kërko
Emër
Rrëti
Kategori
KONTAKTI:
r.nazarko@gc-al.com
Cel: 0672892912
0682226362
0692315246
Agjensia Albinfo

- Qellimi i ketij projekti eshte qe keto faqe inteneti te sherbejne si nje portal infomacioni shumeqellimesh.
- Ky projekt ploteson nevojat per informacion ne fushat e Turizmit, Biznesit dhe Real Estate

GEOILIRI GJEODEZI



GEOILIRI GJEODEZI

INXHINIER GJEODET

GeoIliria eshte nje shoqeri tregetare qe merret me punime Topografike dhe Gjeodezike.

- **Sherbimet Inxhinierike.**

Studime dhe rilevime topografike ne rruge, kanalizime, dhe ujesjellsa.

Projektme ne rruge, kanalizime, dhe ujesjellsa.

Rilevime per qellime elektro-energjitike dhe telekomunikacion.

- **Sherbimet Kadastrale.**

Rilevime topografike ne tokat bujqesore, pyje, kullota.

Percaktim dhe identifikim i kufijve.

Matje apo llogaritje te siperfaqes.

Ndarje ose bashkim i pasurive (toka bujqesore, troje, pyje, kullota, etj.)

Akte ekspertimi per gzykate.

- **Plane Rilevimi.** (Per ne Agjensine e Kthimit dhe Kompesimin e Pronave, Zyren e Rregjistrimit, Agjensine e Privatizimit, Entin e Banesave, etj.



Kontakti:
albaniamap@yahoo.com
Cel 0672892912

Këshilli i Konsultativ për botimin e Revistës “Gjeodeti”

Hartimi, konceptimi dhe përmbajtja e Revistës “Gjeodeti” është bërë në konsultim të gjërë me Kryesinë e SHGJSH-së, përfaqësues të sektorit publik e privat, inxhinier të licensuar, pedagogë, studentë, specialistë të administratës publike etj. Shoqata e Gjeodetëve të Shqipërisë gjen rastin të falenderoj personat e mëposhtëm të cilet me vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet konkrete, kanë mundur realizimin e një botimi shumë dinjitoz të Revistës “Gjeodeti”.

Bledi Stefa	Jak Suli
Romeo Nazarko	Anri Saja
Qemal Skuka	Shabedin Toska
Hiqmet Gonxhe	Lorenc Zani
Ylli Kolonja	Perparim Ndoi
Asllan Bebeçi	Azbi Arapi
Gezim Bisha	Fatmir Ejupi
Alban Hasa	Petrit Jani
Altin Pojani	Brian Osmanagaj
Ylber Shabani	Alban Suku
Besnik Hysaj	Julian Ismaili
Edison Sinanaj	Hysni Ruka
Lorenc Çala	Gjergji Begaj
Kostandin Qirjazi	Eriseld Hila

Përmbajtja

Faqe 6	Raport 22 Janar 2011
Faqe 13	Publikim “Dita e Gjeodetit”
Faqe 14	Anëtarët e Nderit të SHGJSH-së
Faqe 15	Konferenca e Parë “Young Surveyors”
Faqe 18	Profili i Kryesisë së SHGJSH-së
Faqe 22	Këshilli i Gjeodetëve të Europës
Faqe 23	Grupi European i Gjeodetëve
Faqe 24	Markat
Faqe 25	Çfarë është ALBPOS
Faqe 28	Sfidat në Aplikimin e Gjeodezisë
Faqe 32	Çmimet Aktuale të Punimeve Topografike dhe Gjeodezike

Njoftim

Shoqata e Gjeodetëve të Shqipërisë, me rastin e festimit të “Ditës së Gjeodetit” e cila do të mbahet çdo 22 Janar, inkurajonë dhe mirëpret propozimet për personat e shquar të profesionit për tu trajtuar sipas rregullores së dhënies së titujve dhe dekoratave, nga Presidenti i Republikës. Shoqata e Gjeodetëve të Shqipërisë, të gjitha propozimet, rekomandimet si dhe çdo lloj dokumenti të nevojshëm lidhur me ndihmesën e arritjeve të këtyre titujve apo dekoratave, do t’ia përciellë Institucionit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Këto propozime apo rekomandime do të bëhen konform ligjit Nr. 8113, Datë. 28. 03. 1996, “Për Dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe rregullores “Mbi Procedurat e Dhënies së Dekoratave dhe Titujve të Nderit nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë.

RAPORT

Mbi zhvillimin e Konferencës së Përgjithshme të Anëtarëve të Shoqatës së Gjeodetëve të Shqipërisë me rastin e 20 Vjetorit të themelimit të kësaj Shoqate.

Pjesa e Parë

Nën kujdesin e Kryesisë së Shoqatës së Gjeodetëve të Shqipërisë si dhe Kryetarit të saj, Z. Bledi Stefa, në datën 22 Janar 2011, Ora 10: 00, në ambjentet e Resortit “Te Stela” u zhvillua Konferenca e Përgjithshme e Shoqatës së Gjeodetëve të Shqipërisë. Kjo Konferencë përkonte me 20 Vjetorin e Themelimit të SHGJSH-së, thënë ndryshe ky organizim ishte më tepër se sa një Konferencë.

Përpara fillimit të Konferencës, në saj të bashkëpunimit dhe mbështetjes së Stafit të Resortit “Te Stela”, për pjesmarrësit ishte organizuar dhe vënë në dispozicion kohë e mjaftueshme për të konsumuar kafën e parë të fillimit të ditës si dhe për tu njohur me ambjentin ku do të zhvillohej ky Event.

Në Konferencë morën pjesë, kompani private të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në fusha të ndryshme të Gjeodezisë, persona të shquar vendas dhe të huaj. Gjithashtu të pranishëm ishin Inxhinier Gjeodet nga Trevat Shqipëtare si Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva etj.

Të pranishëm në Konferencë ishin edhe të ftuar special si Dr. Chryssy Potsiou, përfaqësuesja dhe Zëvendës Presidentja e Federatës Ndërkombëtare të Gjeodetëve, me seli në Danimark (FIG International Federation of Surveyors). Znj. Chryssy Potsiou ishte e deleguar nga Federata Ndërkombëtare e Gjeodetëve për të qënë e pranishme dhe për të ndjekur zhvillimin e kësaj Konference. Një tjetër i ftuar special ishte Z. Nikolaos Zacharias, Zëvendës President i “European Group of Surveyors” njëherazi dhe Sekretar i Përgjithshëm i Hellenic Association of Rural and Survey Engineers.

Nderonte me pjesëmarrjen e tij, Prof. Dr. Murat Meha, Kryeshf i Agjensionit Kadastral të Kosovës. Të pranishëm ishin përfaqësues nga Shoqata e Gjeodetëve të Kosovës, Inxhinier Gjeodet dhe Kompani Private të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në fusha të ndryshme të Gjeodezisë. Gjithashtu të ftuar nga Kosova ishin, përfaqësues të Universitetit të Prishtinës dhe Departamentit të Gjeodezisë.

Të ftuar ishin përfaqësues nga Shkupi si dhe shumë Inxhinier Gjeodet nga Maqedonia. Të pranishëm ishin përfaqësues nga Presheva, Greqia si dhe nga Mali i Zi, të cilët ndoqën me shume vëmendje këtë event.





Në Konferencë morën pjesë shumë personalitete të njohura nga Shqipëria. Një prej tyre ishte Keshilltari i Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë Z. Pjerin Marku i cili mbajti fjalën e hapjes së kësaj konference.

Nderoi me pjesmarrjen e tij Dr. Stavri Ristani, Pedagogë, ish-Zëvendës Ministër në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit i cili spikati me një fjalim shumë interesant përpara gjithë të pranishmëve, duke e ngritur rolin dhe figurën e Gjeodetit në sferat më të larta të shoqërisë.

Mori pjesë Prof. Dr. Andrea Maliqari, Dekan i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit. Së bashku me Profesor Andrean ishin Dr. Gëzim Gjata, Shef i Departamentit të Gjeodezisë si dhe një pjesë e madhe e Pedagogëve të këtij Departamenti. Ndër të tjera, morën pjesë edhe Shoqata si-motra, anëtarë dhe simpatizantë të SHGJSH-së.

Pjesmarrja vendase ishte e madhe. Në sallë gjëndeshin Inxhinier e specialist Gjeodet nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme, nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, nga Aluizni, nga Agjensia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave si dhe nga shume Institucione të tjera private dhe shtetërore ku Gjeodetët ushtrojnë profesionin e tyre.

Në Konferencë përshëndetën me fjalën e tyre, Z. Pjerin Marku Këshilltar i Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, Z. Stavri Ristani Pedagogë, ish-Zëvendës Ministër në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Z. Andrea Maliqari Dekan i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Z. Murat Meha Kryeshef i Agjensionit Kadastral të Kosovës, Z. Përparim Ameti Shef i Departamentit të Gjeodezisë në Universitetin e Prishtinës, Z. Gëzim Gjata Shef i Departamentit të Gjeodezisë pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Tiranë, Përfaqësues nga Shoqata e Gjeodetëve të Kosovës. Z. Daut Bejta përfaqësues i Gjeodetëve të Malit të Zi, Znj. Chryssy Potsiou Zëvendës Presidente e International Federation of Surveyors, Z. Nikolaos Zacharias Sekretar i Përgjithshëm i Hellenic Association of Rural and Surveying Engineers njëherazi Zëvendës President i European Group of Surveyors. Z. Bledi Stefa Kryetar i Shoqatës së Gjeodetëve të Shqipërisë etj. Në fjalën e mbajtur nga Kryetari i SHGJSH-së, Z. Bledi Stefa u theksua në mënyrë të veçantë mbrojtja e interesave të Gjeodetit, rritja e nivelit profesional, akademik dhe institucional. Ulja e problemeve që shfaqen në punën e Gjeodetit si dhe nevoja për egzistencën e Shoqatës. Gjthashtu Z. Stefa nuk la pa përmendur shume inxhinier Gjeodet, profesor dhe specialist të cilët nuk jetojnë më. Këta edhe shumë persona të cilët, pjesën më të madhe të jetës së tyre ia kushtuan Profesionit të Bukur të Gjeodetit.

Ndër të tjera, gjatë fjalimit u shfaqën edhe objektivat e SHGJSH-së.



Kryesore ishin:

- Botimi i një Buletini Gjeodezik i cili do të shpërndahej jo vetëm ne Shqipëri dhe në trevat Shqipëtare por në mbarë botën ku punojnë e jetojnë Gjeodetë
- Pjesmarrja në konferenca të ndryshme
- Ngritja e komisioneve të specializuara
- Bashkëpunimi dhe mbështetja për Strukturën "Young Surveyors"
- Mbështetje të gjitha kompanive dhe firmave të ndryshme private që mbulojnë fusha të caktuara të Gjeodezisë
- Një tjetër objektiv ishte mbështetja e Shtetit për hartimin e legjislacionit në mënyrë që ligjet dhe rregulloret e ndryshme të jenë sa më në favor të Gjeodetit

Z. Stefa uroj miqtë për pjesmarrjen e tyre masive si dhe përcolli urimin dërguar nga Presidenti i Federatës Ndërkombëtare të Gjeodetëve Z. Teo Che Hai, drejtuar Shoqatës së Gjeodetëve të Shqipërisë si dhe Konferencës së Përgjithshme të kësaj Shoqate.



PUNIME TOPOGJEODEZIKE

"GJEODETIKA 2010"

e-mail: gjeodetika_2010@yahoo.com

Pjesa e Dytë

Pjesa e dytë e konferencës shpalosi prezantimet e mbështetësve të eventit. Kompanitë private, firmat e ndryshme dhe studiot topografike njohën të pranishmit me teknologjinë më të fundit të Instrumentave gjeodezike si dhe produkteve të tjera. Këto prezantime shërbyen tek të gjithë si një ri-ndezje e njohurive profesionale të ndërthurura me avancimin e teknologjisë.



Pjesa e Tretë

Në pjesën e tretë të Konferencës u paraqitën punime shkencore, studime, prezantime nga Inxhinier, Pedagogë e Profesionistë të ndryshëm të fushës së Gjeodezisë. Prezantimi i këtyre punimeve ishte individual dhe me bashkëautorë.

Hapjen e fazës së tretë të Konferencës e bëri e ftuara speciale si dhe personi i deleguar posaçërisht nga Federata Ndërkombëtare e Gjeodetëve me seli në Danimark, Dr. Chryssy Potsiou. Profesoresha Potsiou paraqiti punimin e saj me temë "Land Reforms and the Importance of Security of Tenure".

Më pas një tjetër i ftuar special, Prof. Dr. Murat Meha, Kryeshef i Agjensionit Kadastral të Kosovës paraqiti punimin e tij me temë "Sistemi i Informacionit Kadastral te Tokave ne Kosove" Mundesi e Re per nje Sherbim me te Mire. Prezantimi që Prof. Meha paraqiti tek të pranishmit ishte një punim me bashkautorë. Prezantimi i rradhës vinte nga Kryetari i SHGJSH-së Z. Bledi Stefa në bashkëpunim me Z. Lorenc Zani. Tema e këtij punimi ishte "Çfarë është ALBPOS" sistemi që zëvendëson Triangolacionin Shqipëtar. Në këtë prezantim Z. Stefa përmendi

nevojën për ndërtimin e një sistemi të ri, funksionimin dhe avantazhet që sillte ndërtimi i rrjetit, ku mund të aplikohet ky sistem si dhe problematikat që haseshin deri në momentet aktuale. Më pas vijuan edhe prezantime të tjera me tematika shumë të spikatura profesionale, nga Prof. Gëzim Bisha me bashkë autorë, Prof. Përparim Ameti, Selim Cacaj, etj..

Struktura me e re ndihmëse njëkohësisht dhe paralele me Shoqatën e Gjeodetëve të Shqipërisë e quajtur "Young Surveyors" Gjeodetët e së Ardhmes, paraqitën një punim shumë interesant, i cili ju drejtohej Kompanive Private, Institucioneve të Administratës Shtetërore, Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit që të ndihmonin me kapacitetet e tyre ngritjen profesionale, të mundësonin praktika profesionale, etj.

Kryetari i SHGJSH-së Z. Bledi Stefa, Nën Kryetarja Znj. Aleksandra Mahmutllari dhe Sekretari i Përgjithshëm i Z. Alban Hasa sollën prezantimin me temë "Shpronësimet Publike dhe Objektet e Banimit". Ky prezantim paraqiste në mënyrë të përmblendhur procedurat që ndiqnin in-

stitucione të ndryshme lidhur me shpronësimet publike. Gjithashtu nxirrte në pah problematikën e tyre si dhe jepte sugjerime se si mund të përmirësohej situata duke përdorur teknologjinë më të avancuar. Objektet e banimit merrnin një trajtim më të gjërë duke qënë se janë edhe shtresa më e prekur e këtij procesi. Pra ky studim përfundonte me sugjerimin që shpronësimet publike dhe në veçanti objektet e banimit duhet të shpronësohen me vlerë reale tregu në mënyrë që të ulej problematika.





Pjesa e Katërt

Në këtë fazë të Konferencës ishte caktuar në dispozicion kohë e mjaftueshme për të bërë pyetje të ndryshme si dhe sugjerime nga gjithë të pranishmit në sallë. Pyetjet dhe sugjerimet mund të ishin rrjedhojë e punimeve të ndryshme të prezantuara më parë apo edhe sugjerime që preknin problematika të caktuara të profesionit.

Në pjesën e fundit të kësaj Konference ishte përgatitur edhe një koktej për të pranishmit.

Ndarja e Titujve

Gjatë zhvillimit të Konferencës u ndanë tituj për personat me kontribut të lartë në fushën e Gjeodezisë. Në bazë të statutit të Shoqatës së Gjeodetëve të Shqipërisë konkretisht, nenit 14 mbi “Anëtarësimin”, me propozim të Kryetarit të Shoqatës së Gjeodetëve të Shqipërisë Z. Bledi Stefa, Këshilli Drejtues, vendosi të zgjedh Anëtar Nderi të Shoqatës së Gjeodetëve të Shqipërisë për kontributin e lartë të dhënë në fushën e Gjeodezisë persona të shquar të profesionit (emrat vijojnë më tej). Ndarja e Çertifikatave “Anëtar Nderi” u realizua nën kujdesin e Nën Kryetares së SHGJSH-së, Znj. Aleksandra Mahmutllari.

Referuesit dhe mbështetësit, në mënyrë sistematike kërkonin nga Shoqata e Gjeodetëve të Shqipërisë shumë më tepër kohë për të paraqitur idetë, punimet apo produktet e tyre. Si rrjedhojë e kësaj, Konferenca përfundoi 1 orë e 20 minuta me vonese dhe kjo, vërteton faktin se sa e nevojshme është mbajtja e konferencave të tilla apo seminareve të ndryshme profesionale që deri tani kishin munguar. U duk qartë dhe hapur se sa etje kishin specialistët Gjeodet, pedagogët, miqtë dhe të ftuarit, kompanitë private, sikur të kishin në dispozicion edhe pak më tepër kohë për të shpalosur gjithë atë energji të akumuluar prej sa e sa vitesh.

Një falenderim shumë i madh për të gjithë miqtë dhe koleget të cilët morën pjesë në konferencën më të madhe të gjeodezisë të mbajtur ndonjëherë jo vetëm në trojet Shqipëtare por edhe jashtë saj. Rreth 400 të pranishëm, Inxhinier Gjeodet dhe Topograf nga të gjitha trevat Shqipëtare, kompani private, pedagoge, përfaqësues të lartë të shtetit, studentë të cilët, u njohën me arritjet më të reja të teknologjisë inxhinierike. Me punimet dhe prezantimet nga më cilësorët të paraqitura më parë, si dhe me një mbështetje maksimale nga shtresat më të larta të biznesit, administratës publike, pedagogjike, profesionistëve e shumë grupeve të tjera të interesit.

Shoqata e Gjeodetëve të Shqipërisë gjen rastin të faleminderoj edhe ata persona të cilët për arsye objektive nuk arritën të ishin pjesë e kësaj konference. Data 22 Janar 2011 do të mbahet mend gjatë në memorien e gjithsecilit prej nesh, si dita ku mbizotruan vlerat e vërteta profesionale, vlerat e vërteta akademike, vlerat e vërteta dhe arritjet e teknologjisë, vlerat e vërteta të studentit dhe mbi të gjitha vlerat e vërteta të një pune të palodhshme e cila realizohet nën ndjenjën e veçantë për profesionin.

**DATA 22 JANAR 2011 DO TË MBAHET MEND
SI DITA E VLERAVE TË GJEODETIT.**

FENO

The permanent survey marker

Designed in 1970,
The FENO Survey marker remains a
unique concept:

- The « polyroc » marker's head is built out of a secret concrete mix, harder than granite.
- The hot dip galvanized anchor is installed with a minimum effort in few minutes and offers an unbelievable uprooting resistance.

Exported all around the world "The unique FENO CONCEPT" is offered with a large range of topographical accessories for setting up, referencing and transporting.



More than 30 references
of Survey marker's head

Patented locking sleeve

3 standard lengths of
anchorage

3 strong extendable
steel flukes

Underground reference mark

Colored survey nail and colored identity disk for
underground networks markings. Available in
various colours and possibility to engrave
desired information such as text, logos or a
logical series of numbers



Bornes FENO-Société Faynot
BP13 - F-Thilay
Tél : 00(33) 3 24 33 70 70 - Fax : 00(33) 3 24 32 84 93
www.faynot.com - contact@faynot.com

Fjala e Z. Bledi Stefa *Kryetar i Shoqates se Gjeodeteve te Shqiperise*

20 Vjet SHGJSH



Të nderuar Zonja dhe Zotërinj

Jam shumë i lumtur që përshëndes të pranishmit e nderuar të kësaj salle, miqtë dhe bashkëpunëtorët e mi, ata që vazhdimisht kanë kontribuar në foltoret e konferencave të ndryshme dhe ata që janë për herë të parë në auditorin e sivjetshëm. Fillimisht dua ti uroj Shoqatës së Gjeodetëve të Shqipërisë, Gëzuar 20 vjetorin e Themelimit të saj dhe jetë sa me të gjatë. Shqipëria dhe Shoqata jonë këto 20 vjet që prej themelimit të saj nga kolege e inxhinier të nderuar shumicen e te cileve i kemi te pranishem ne kete salle, ka ecur në rrugën e përparimit. Gjeodezia tashmë, përfundimisht është orientuar drejt zhvillimit. Një falenderim i veçantë do të shkojë për Mbështetësit e Konferencës së SHGJSH-së. Në fjalën time nuk mund të lë pa falenderuar edhe miqtë të cilët i kemi present jo vetëm nga Shqipëria por edhe nga Treva të tjera, si dhe jashtë saj.

Fillimisht një falenderim special shkon për Zonjën dhe Profesoreshën Chryssy Potsiou e cila njëherazi është edhe e dërguara e International Federation of Surveyors (Federata Ndërkombëtare e Gjeodetëve) në të cilën, SHGJSH, në Datën 8 Qershor 2010 u bë anëtare e kësaj Federate kaq të madhe. Gjithashtu dua të falenderoj edhe bashkëshoqëruesin e Znj. Chryssy Potsiou, Z. Nikolaos Zaharias Sekretar i Përgjithshëm i Hellenic Association of Rural and Survey Engineer, njëherazi Zëvendëspresident i EGoS.

Falenderoj për pjesmarrjen e tyre:

Përfaqësuesit e Shoqatës së Gjeodetëve të Kosovës. Prof. Murat Meha, Kryeshef i Agjensise Kadastrale te Kosovës, Prof. Përparim Ameti, Shef i Departamentit te Gjeodezise ne UP si dhe të gjithë kolegët e tij bashkëshoqërues, gjithashtu falenderoj të gjithë te ftuarit e tjerë nga Maqedonia, Mali i Zi dhe Presheva. Falenderoj gjithashtu Këshilltarin e Kryeministrit të Rep. së Shqipërisë, Z. Pjerin Marku Dr. Stavri Ristanin, Pedagoge, Ish-zëvendësministër i Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit Kryesinë e Shoqatës së Gjeodetëve të Shqipërisë. Gjithë të pranishmit, Anëtar, Simpatizant, Përfaqësues të shoqatave si motra në Rep. e Shqipërisë etj...

Të nderuar Zonja dhe Zotërinjë siç edhe ju e keni ndjekur, aktiviteti i SHGJSH-së është zgjeruar dhe është bërë një faktor shumë i rëndësishëm në mbrojtjen e interesave tona të përbashkëta.

SHGJSH ka bërë një punë të madhe në shumë drejtime si dhe do vazhdojë akoma edhe më tepër të punojë për të arritur qëllimet të cilat i përmban edhe statuti i saj. Qëllimet nuk mund të jenë tjetër përveç se:

- Mbrojtja e interesave Teknike, Juridike, Ekonomike të Gjeodetit kudo që ai punon dhe jeton.
- Rritja e nivelit Profesional, Akademik dhe Institucional
- Mbrojtja e punëve që kryen Gjeodeti në fusha të ndryshme si dhe reklamimi i tyre në mbarë shoqërinë.

Nuk dua të ndalem tek problematika që hasim ç'do ditë në punën tonë profesionale si Ju ashtu edhe unë por, dua t'ju sjell në vëmendje që së bashku të punojmë lidhur me minimizimin e të gjitha problemeve që ne si bashkësi hasim në punën tonë profesionale. I ftoj të gjithë Grupet e Interesit, Topografët, Gjeodetët, Kompanitë Private, Studiot Topografike të kontribuojnë duke bërë të mundur, evidentimin e të gjitha problemeve që shfaqen me ose pa dashje duke përguar dhe

demtuar imazhin tonë. I ftoj gjithashtu Grupet e Interesit, Topografët, Gjeodetët, Pedagogët, Kompanitë Private, Studiot Topografike, të kontribuojnë duke bërë të mundur që Konferenca të tilla të bëhen edhe në vazhdim, ku gjithë materiali i mbledhur prej tyre, së bashku me problematikën që mbart në vetvete, mos të mbyllet diku në ndonjë sirtar apo zyrë, por të depozitohet zyrtarisht pranë organeve kompetente të cilat i japin zgjidhje problemeve tona.

Ju bëj thirrje të gjithë kolegëve, antarëve të SHGJSH-së (jo si Bledi Stefa por si një Inxhinier Gjeodet) të rrisim bashkëpunimin midis njeri-tjetrit pasi nevoja për egzistencën e Shoqatës do të thotë: Përballim sa më i lehtë i të gjitha sfidave që na presin përpara, gjatë ushtrimit të karrierës tonë profesionale. Synimet dhe objektivat e SHGJSH-së janë të shumta. Ndër më të rëndësishmit është botimi në mënyrë sistematike i një Buletini Informativ Gjeodezik i cili do ti shërbej jo vetëm Gjeodetit por të gjitha shtresave dhe faktorëve të Shoqërisë. Ky Buletin do mund të shpërndahet jo vetëm në Shqipëri por edhe në mbarë botën ku punojnë e jetojnë Gjeodetët.

Do të përpiqemi të marrim pjesë në Konferenca të ndryshme si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj për të sjell me pas ç'do zhvillim, ç'do të re që ndodhë me profesionin tonë në mbarë botën. Në vazhdim do të krijohen komisione të specializuara në fusha të ndryshme të Gjeodezisë. Këto komisione do të kenë për sejcilin prej tyre një udhëheqës, si dhe do të ngrihen grupe pune për tema të veçanta. Të gjithë Qytetet e Shqipërisë kanë të drejtë të caktojnë përfaqësues në këto komisione. Do të kontribuojmë në rritjen dhe përparimin e strukturës të sapo formuar Young Surveyors (Gjeodetët e Së Ardhmes) për të përmirësuar numrin e profesionistëve të rinj dhe për ti ndihmuar ata në fillim të karrierës së tyre.

Do të krijojmë një bashkëpunim shumë më të mirë me të gjitha Kompanitë e Instrumentave Gjeodezik, Studiot Topografike si dhe me të gjithë Inxhinieret Gjeodet kudo që ata punojnë dhe jetojnë. Do të mbështesim Shtetin për hartimin e legjislacionit në mënyrë që ligjet dhe rregulloret e ndryshme të jenë sa më në favor të Gjeodetit. Do të krijojmë bashkëpunim edhe më të madh me Kompanitë Private, Shoqatat homologe brenda dhe jashtë vendit. Do të rrisim bashkëpunimin me Fakultetin e Inxhinierisë së Ndertimit dhe Departamentin e Gjeodezisë

Në mbyllje të fjalës time, duke shprehur të kem përcjellë gjithë falenderimin tim për praninë tuaj në sallë, i uroj kësaj konference punë të mbarë

Ju faleminderit!

Bledi Stefa

Kryetar i SHGJSH-së

Publikimi i datës 22 Janar si “Dita e Gjeodetit”

Duke u nisur nga data 22 Janar 2011, ditë në të cilën Shoqata e Gjeodetëve të Shqipërisë organizoi Konferencën e Përgjithshme të Anëtarëve si dhe festoj 20 vjetorin e themelimit të saj, lindi e nevojshme përcaktimi i një dite kushtuar profesionit të Inxhinierit Gjeodet si dhe kontributit që ai jep në këtë fushë. Është e domosdoshme “Bërja Traditë” e kësaj dite duke u solidarizuar me profesionin e Gjeodetit dhe duke e renditur atë në sferat më të larta të shoqërisë ku

jetojmë e punojmë.

Në konferencës e datën 22 Janar 2011 morën pjesë rreth 400 të pranishëm, Intelektual, Akademik, figura të shquara të profesionit, Inxhinier Gjeodet, Student etj. Të ftuar ishin përfaqësues nga të gjitha trevat Shqipëtare si Kosova, Maqedonia, Mali i Zi e Presheva. Gjithashtu, Federata Ndërkombëtare e Gjeodetëve, me seli në Danimark, përfaqësohej nga Zëvendëspresidentja e saj. Të ftuar ishin edhe përfaqësues nga Shtete si Greqia, Austria dhe Sue-

dia. Kjo konferencë do të mbahet mënd gjatë nga të gjithë, si mbledhja më e madhe e organizuar më parë, kushtuar këtij profesioni kaq fisnik.

Nisur nga sa më sipër, Shoqata e Gjeodetëve të Shqipërisë ndër-mori një solidarizim duke nënshkruar një formular nga shumica e Anëtarëve të saj, mbi mbështetjen për shpalljen e datës 22 Janar 2011 si “Ditën e Gjeodetit”.

Anëtarët e nderit të shoqatës së Gjeodetëve të Shqipërisë

Në bazë të statutit të Shoqatës së Gjeodetëve të Shqipërisë konkretisht, nenit 14 mbi “Anëtarësimin”, me propozim të Kryetarit të Shoqatës së Gjeodetëve të Shqipërisë, Këshilli Drejtues ka vendosur të emërojë “Anëtar Nderi” për kontribut të shquar dhënë në fushën e Gjeodezisë, personat e mëposhtëm:

- | | | |
|----------------------|-------------------|----------------------|
| • Chryssy Potsiou | • Harald Schuh | • Ylli Kolonja |
| • Kurt Bretterbauer | • Qazim Striniqi | • Hyqmet Gonxhe |
| • Muharrem Dragovoja | • Qemal Skuka | • Murat Meha |
| • Gjergji Qelesi | • Muharrem Sesei | • Abdurrahman Kuleta |
| • Ahmet Jazo | • Nexhat Turkeshi | • Përparim Ameti |
| • Sashenka Foto | • Hyqmet Demiri | |

Fjala përshendetëse nga Shoqata e Gjeodetëve të Kosovës dhe Kryetari i saj, Z. Abdurrahman Kuleta

Përshëndetje Z. Bledi

Me gëzoi shumë lajmi i shpjeguar se Shoqata e Gjeodetëve të Shqipërisë (SHGJSH), planifikon të përgatisë për botim revistën e SHGJSH-se. Me këtë lajmë neve si Shoqatë e Gjeodetëve të Kosovës, por edhe unë si Kryetar i Shoqatës u gëzova pamase, cak me shtyri që tu përgëzoje për hapat e ndërmarra si në aspektin e forcimit të organizimit të shoqatës, mbajtjen e takimeve të përbashkëta të shoqatave simotra, avancimin dhe ngritjen e SHGJSH me kyçe në institucionet dhe trupat ndërkombëtare të FIG-ut, si dhe organizimin e Gjeodetëve të Rinj dhe se fundit edhe nevojën e botimit të revistës së SHGJSH, me një emër shumë të qëlluar “GJEODETI”. Me këto veprime të udhëhequra nga SHGJSH, trasohen horizonte të mundshme që SHGJSH, të afirmohet edhe më tej, me mundësinë e prezantimit të arritjeve si në aspektin e zhvillimeve të mëtejme po ashtu edhe zhvillimet në fushat e gjeodezisë, kadaster, veprave inxhinierike, pronësisë etj. Me kalimin e kohës besoj që edhe SHGJK, do gjene vend dhe hapësirë në zhvillimet e mëtejme të revistës. Sidoqoftë edhe një herë Ju përgëzoj për veprimet lidhur me publikimin e revistës së gjeodetëve, duke e përgëzuar udhëheqjen e SHGJSH.



Me respekt
Abdurrahman Kuleta,
Kryetar i SHGJK

Shefi i Departamentit të Gjeodezisë, në Universitetin e Ndertimtarisë dhe Arkitekturës Prishtinë, përcjellë fjalën e tij drejtuar Gjeodetëve Shqiptarë

Të nderuar lexues



Dr. Përparim Ameti
Profesor vizitor
Ohio State University
Columbus, Ohio, SHBA

Profesioni i gjeodezisë në 20 vitet e fundit ka pësuar aq shumë ndryshime sa që me shumë të drejtë mund të thuhet që trendi i zhvillimit të tij kërkon një angazhim të veçantë. Ky trend i zhvillimit kërkon një qasje të re ndaj këtij profesioni, përpos aspektit klasik matematikor, një vëmendje tjetër duhet kushtuar edhe teknologjisë. Që nga aplikimi i metodave satelitore në fillim të viteve 90 dhe së bashku me zhvillimin e GIS, gjeodezia është shndërruar në një profesion modern high-tech dhe shumë atraktiv jo vetëm për gjininë mashkullore por edhe nga gjinia femërore. Një trend në rritje është duke u zhvilluar në nivel global të interesimit të femrave për këtë profesion, andaj do të ishte një inkurajim shtesë edhe për femrat shqiptare. Nisma për këtë revistë është e qëlluar dhe domosdoshmëri e kohës për ti përmbushur zhvillimet e cekura më lartë. Kjo ide është shumë produktive dhe do të inkurajojë një komunikim më të madh profesional në mes të shqiptarëve kudo që gjinden ata.

Konferenca e Parë Young Surveyors

Në datën 25/11/2010 ora 16:00 u zhvilluan zgjedhjet e strukturës ndihmëse, paralele të Shoqatës së Gjeodetëve të Shqipërisë. Kjo strukturë do të quhet **“Young Surveyors” “Gjeodetët e së Ardhmes”** e cila do të bashkërendojë punën me SHGJSH-në në lidhje me programin, qëllimet statutin dhe çdo objektiv tjetër që ndihmon në përparimin, integrimin dhe zhvillimin e Shkencës së Gjeodezisë. Struktura **“Young Surveyors” “Gjeodetët e së Ardhmes”** do të shërbejë si urë lidhëse midis Studentëve të Gjeodezisë, SHGJSH-së, Kompanive apo Bizneseve private, Administratën Shtetërore etj....në mënyrë që brezat e rinj të cilët diplomohen në këtë degë të jenë sa më të kualifikuar, të arrirë në teknologji si dhe sa më të aftë për tregun e punës. Gjithashtu ky lloj bashkëpunimi do t’ju shërbejë Gjeodetëve të së Ardhmes të njohin mirë dhe të kenë informacion në lidhje me Institucionet Shtetërore të cilët mund të kenë nevojë për specialist Gjeodet, kompanitë private që ushtrojnë punën dhe biznesin e tyre në spektrin e Gjeodezisë.



Organizimi i bërë nga Shoqata e Gjeodetëve të Shqipërisë, nën kujdesin e veçantë dhe sistematik të Z. Bledi Stefa, Kryetar i SHGJSH-së.

Qëllimi: Do të kontribuojmë në rritjen dhe përparimin e strukturës të sapo formuar Young Surveyors (Gjeodetët e së Ardhmes) për të përmirësuar numrin e profesionistëve të rinj dhe për ti ndihmuar ata në fillim të karrierës së tyre.

Në datën 1 Maj 2011, ditë e dielë, në ambjentet e Hotel Mondial u zhvillua Konferenca e Parë “Young Surveyors”, Gjeodetët e së Ardhmes. Zhvillimin dhe mbarvajtjen e kësaj Konference e ndoqën një sërë Institucionesh si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Ndër mbështetësit dhe organizatorët kryesor ishin **Shoqata e Gjeodetëve të Shqipërisë** e cila me gjithë potencialin e saj u kujdes nga fillimi deri në mbylljen e këtij event



sa të veçantë, aq edhe madhështorë. Mbështetje dhanë edhe një numër i konsiderueshëm Institucionesh të cilat po i përmendim pak më posht: Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Instituti Gjeografik i Ushtrisë, Agjensia Kadastrale e Kosovës, Departamenti i Gjeodezisë, pranë Universitetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, Prishtinë Departamenti i Gjeodezisë, FIN, Shoqata e Gjeodetëve të Kosovës etj. Programi

i cili u shpalos gjatë kësaj konference, ishte i larmishëm, profesional dhe shumë i vlefshëm për të gjithë faktorët që janë pjesë e këtij profesioni. Pjesëmarrës në Konferencën e Parë “Young Surveyors” (Gjeodetët e së Ardhmes) ishin Inxhinier, Pedagogë, Student dhe Gjeodet të cilët e ushtrojnë profesionin e tyre si në Administratën Publike ashtu edhe në atë private. Edhe kësaj rradhe nuk munguan





miqtë nga vendet fqinje si, Kosova, Maqedonia dhe Presheva.

Këtë konference e nderoi me pjesmarrjen e saj Znj. Elfrida Alliu, Zëvendës Dekane e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit. Prof. Elfrida Alliu shoqërohej nga një numër i konsiderueshëm Pedagogësh të po këtij fakulteti. Në fjalën e saj Prof. Elfrida përshëndeti gjithë të pranishmit si dhe vuri theksin në rëndësinë e profesionit si dhe organizimeve, konferencave apo seminareve të këtij lloji.

Më pas vijuan:

Z. Romeo Nazarko me prezantimin e tij me temë “Adresari Elektronik për Shqipërinë”. Z. Anri Saja, përfaqësues i Komunës Kashar paraqiti punimin e tij me teme: “Evidentimi i Problematikave në Punët Topo Gjeodezike në Komuna. Sugjerime dhe rekomandime për minimizimin dhe parandalimin e këtyre problemeve”. Z. Avni Ahmeti mik i ftuar nga Kosova, paraqiti punimin e tij me temë “Zhvillimi i Kadastrës në Republikën e Kosovës”. Ndër të tjera, paraqitja e dy prej mbështetësve kryesor të kësaj konference, i dha një dimension tjetër Eventit. Trimble Distributor, Geotrim L.t.d, përfaqësuar nga Administratori Z. Azbi Arapi dhe Sokkia Distributor, Geotech Sh.p.k, përfaqësuar nga Administratori Z. Ylber Shabani, paraqitën përpara të publikut profilin e kompanive respektive, produktet e tyre si dhe shumë detaje të tjera profesionale.

Gjatë konferencës u ndanë edhe Çertifikata për mbështetjen e dhënë lidhur me organizimin e Konferencës së Parë “Young Surveyors” Gjeodetët e së Ardhmes.

Në fjalën e tij, Kryetari i SHGJSH-së Z. Bledi Stefa u ndal në falenderimin e mbështetësve kryesorë të eventit si dhe nuk la pa përmendur stafin e Hotel Mondial veçanërisht, Znj. Irena dhe Zak Topuzi administrator të Hotel Mondial. Z. Stefa falenderoj gjithashtu të gjithë institucionet publike, shoqatat homologe, Anëtarët e Nderit të SHGJSH-së, Kryesinë si dhe në veçanti Gjeodetët e së Ardhmes.

20th Anniversary of Albania Association of Geodesy (AAG) 1st General Conference

The Albanian Association of Geodesy celebrated its 20th anniversary since its establishment and organized an one-day Conference in Tirana on the 22nd of January 2011. That was an historic event as it was the 1st Conference of the Albanian association. During these 20 years Albania and its Association of Geodesy (AAG) have both walked in the path of progress. More than 400 participants have attended the Conference, most of them Albanian surveyors from Albania and the neighboring countries in the Balkan region. AAG has become a member Association of FIG on the 8th of June 2010. The technical program included more than 30 presentations; all of them will be published in the



technical journal of AAG.

Organizer of this event was the President of AAG dipl.Ing. Bledi Stefa. Welcome addresses were given by Mr. Pjerin Marku, Advisor of the Prime Minister of Republic of Albania, Prof. Andrea Maliqari, Dean of the Faculty of Construction Engineering, Dr. Stavri Ristani, Professor, former Deputy Minister of Ministry of Public Works Transport and Communications, other members of the Albanian Association of Geodesy and international guests. FIG President, CheeHai Teo, FIG Council and FIG Office have warmly supported this event. FIG President's greeting letter was read during the Conference. FIG Vice President Prof Chryssy A Potsiou has represented FIG; she participated to the Conference, made a welcome address on behalf of FIG and she also gave an invited speech on "Land Reforms and the Importance of Security of Tenure". During the event, the President of AAG has kindly nominated FIG Vice President Prof Chryssy A Potsiou as honorable member of the Albanian surveyors' society. The European Group of Surveyors (EGoS) also supported this Conference. Vice President Nikos Zacharias (also General Secretary of Hellenic Association of Rural and Surveying En-

gineers) made a welcome address. International participants also included President of Kosovo Association of Surveyors Mr. Abdurrahman Kuleta, Prof. Murat Meha, Chief of the Kosovo Cadastral Agency, Prof. Perparim Ameti, Head of the Department of Geodesy in the University of Prishtina. The work plan of the Albanian Association of Geodesy includes among others: all surveying topics, among them geodesy, photogrammetry and other technical aspects, security of tenure and land administration, valuation and compulsory purchase of land, and the creation of the relevant local commissions; regular publishing of the AAG journal; establishment of a Young Surveyors forum; cooperation with the public and private sectors, the academia, the government, and other surveying associations from various countries. The objectives of AAG can be briefly presented in three pillars: 1. Protection of the professional interests of the Albanian surveyors (technical, legal, economic) 2. Capacity Building (Professional, Academic, Institutional) 3. Professional Networking and development of International Activity The Conference included a technical exhibition and dinner for the invited guests offered by the sponsoring companies.

Land&co shpk

Rruga Mine Peza pallati i ri 8-kt ngjitur
me porten e shkolles Hasan Vogli 6/1
Tirane, Albania

cel: +355 682035522

email: info@landcoal.com

Web: www.landcoal.com

**Perfaqesues i autorizuar per
Shqiperine**



PRODUKTE TOPOGRAFIKE/INXHINIERIKE: GPS TE PRECIZIONIT TE LARTE – AUTOMATIZIM NE NDERTIM:SISTEME TE





TOPCON

CONNECTING VISIONS



KONTROLLIT TE MAKINERIVE - PRODUKTE MATESE:GIS DHE IMAZHE DIGJITALE - PRODUKTE PER MINIERA DHE BUJQESI



NJË JETË KUSHTUAR GJEODEZISË

Prof. As. Dr. Ylli Kolonja, i ditëlindjes 11. 08. 1937, kryen studimet në Universitetin e Tiranës, pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Dega Gjeodezi. Formimi profesional dhe aktiviteti i tij fillon menjëherë pas diplomimit në vitin 1962. Fillimisht ka punuar pranë Ndërrmarjes Shtetërore të Ndërtimit Nr. 2, Berat duke mbajtur pozicionin e Kryetarit të Degës Teknike. Më pas, në vitin 1968 ushtroi detyrën e Përgjegjës të Sektorit të Topografisë pranë Institutit të Studimeve dhe Projektimeve të Bonifikimeve, në Ministrinë e Ndërtimit. Prof. Kolonja vjen nga një karrierë e gjatë pedagogjike. Në vitin 1971 fillon të ushtrojë detyrën e pedagogut në Universitetin Politeknik të Tiranës, lektor në lëndën “Gjeodezia Inxhinierike” në Degën e Gjeodezisë. Në vitet 1988-1992 ushtroi detyrën e Përgjegjës të Katedrës së Gjeodezisë Inxhinierike, ku në vitin 1990 do të ushtronte edhe detyrën e Zëvendës Dekanit të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit. Karriera profesionale e Prof. Yllit vazhdon edhe në vitin 2005 si drejtues i punimeve Topografiko-Gjeodezike në ndërtimin e Terminalit të Ri, në **Aeroportin “Nënë Tereza”** Tiranë. Në një periudhë të gjatë kohe drejton Shoqatën e Gjeodetëve të Shqipërisë duke dhënë një kontribut shumë të vlefshëm për të. Largohet me dëshirën e tij nga drejtimi i SHGJSH-së në vitin 2010. Veprimtaria Shkencore e Prof. Ylli Kolonjës rendit një numër të kosiderueshëm botimesh universitare. Në vitin 1982 boton librin Gjeodezia (ushtrime) i cili do të pasohet me tre botime të tjera me tituj Gjeodezia Inxhinierike I, II dhe III. Ndër të tjera, gjenden botime dhe artikuj të ndryshme profesionale të cilat, u kanë shërbyer dhe ju shërbejnë brezave të studentëve të Gjeodezisë dhe degëve të tjera. Kualifikimet dhe vizitat e punës si brënda ashtu edhe jashtë Shqipërisë, janë për tu admiruar. Nisin me kualifikimin pranë Universitetit Politeknik të Torinos. Vizita punë në Institutin Mbretëror të Teknologjisë në Melbourne Australi, Universitetin Teknik të Athinës, Universitetin Teknik të Vienës si dhe vizita të ndryshme punë në Kosovë, Maqedoni etj. Në vitin 1985, me vendimin Nr. 125 merr Gradën Shkencore “Doktor i Shkencave” dhe që prej vitin 1994 gëzon Titullin Shkencor, “Profesor i Asocuar”. Prof. Ylli Kolonja ka marr pjesë në një numër të madh studimesh dhe projektimesh në fushën e Gjeodezisë dhe Topografisë. Sot, Prof. Kolonja, me plot gojën mund të kosiderohet si një ndër personat me kontribut mjaft të gjërë në Gjeodezi i cili, u dha dije, jo vetëm brezave të tërë studentësh por edhe Kombit Shqipëtar.



Kryesia e Shoqatës së Gjeodetëve të Shqipërisë dhe Profili i saj

Mbas dy mbledhjeve të realizuara në FIN, me një pjesëmarrje të admiruar të të pranishmëve në sallë, arritën të zgjidhen strukturat drejtuese të SHGJSH-së, Kryetari dhe Kryesia e përbërë nga 7 vetë. Në këndvështrimin e përgjithshëm, përbërja e kësaj kryesie është për tu admiruar. Gjithpërfshirja e grupeve të interesit në këtë kryesi, e gjen vetën në çdo drejtim të saj. Thënë më thjesht në kryesinë e SHGJSH-së u zgjodhën persona me vlera profesionale, aktivë dhe të përkushtuar në profesionin e Gjeodetit. Kjo kryesi ka në përbërjen e saj individ nga fusha e biznesit, administratës publike, përfaqësues të studentëve, kompanive privatë, pedagogjia etj.

Bledi Stefa

Kryetar i SHGJSH-së

Ka përfunduar studimet pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Dega Gjeodezi. Po në këtë Fakultet, ka kryer studimin Pas-Universitar mbi Vlerësimin e Pasurive të Paluajtshme. Vjen nga një karrierë e gjatë në fushën e pronësisë. Z. Stefa ushtron profesionin e Inxhinierit Gjeodet, pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit. Gjithashtu, është pedagogë i jashtëm pranë Albanian University ku zhvillon lëndën e Topografisë me studentët e arkitekturës. Zgjidhet Kryetar i SHGJSH-së nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve, me një mandat 3 vjeçar (2010-2013).





Aleksandra Mahmutllari

Nën Kryetare

Ka përfunduar studimet pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Dega Gjeodezi. Aktualisht ushtron profesionin si Inxhinier Gjeodete pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve. Propozohet dhe miratohet në mbledhjen e Kryesisë së SHGJSH-së, për të ushtruar detyrën e Nën Kryetares për çështjet organizative në SHGJSH.



Z. Edison Sinanaj

Anëtar

Ka përfunduar studimet pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Dega Gjeodezi. Vjen nga një familje me tradita mbi profesionin e Gjeodetit. Z. Sinanaj gëzon një eksperiencë profesionale dinjitoze, sidomos përsa i përket punëve që përmblendhë profili i Gjeodezisë Inxhinierike. Zgjidhet në Kryesinë e SHGJSH-së nga Asambleja e Përgjithshme dhe vjen si përfaqësues i fushës së biznesit.

Kostandin Qirjazi

Nën Kryetar

Ka përfunduar Universitetin Ushtarak "Skënderbej", Dega Topografi. Zotëron një eksperiencë të gjatë profesionale Topografike dhe Gjeodezike si dhe gëzon vlera të trashëgimit të profesionit të Gjeodetit. Z. Qirjazi zgjidhet Anëtar i Kryesisë së SHGJSH-së. Në mbledhjen e parë të kësaj Kryesie propozohet të ushtrojë detyrën e Nën Kryetarit. Z. Qirjazi vjen në këtë kryesi si përfaqësues i biznesit.



Edmond Leka

Anëtar

Inxhinier Gjeodet me njohje shumë të mëdha profesionale dhe bashkëpunuese. Njohës i mirë i Sistemit të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Sistemeve GIS etj. Ndër vite ka qënë drejtues në institucione që lidhen ngushtë me Gjeodezinë. Në kryesinë e SHGJSH-së, Z. Edmond Leka vjen si përfaqësues i Biznesit.

Alban Hasa

Anëtar

Z. Hasa vazhdon studimet pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Dega Gjeodezi. Vjen nga familje me tradita profesionale Topo-Gjeodezike. Z. Hasa zgjidhet anëtar i kryesisë së SHGJSH-së dhe gëzon statusin e përfaqësuesit të studentëve në Shoqatën e Gjeodetëve të Shqipërisë. Duke qënë aktivë në punët organizative por edhe profesionale, kryesia e SHGJSH-së e zgjedh në pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm të SHGJSH-së.



Gëzim Bisha

Anëtar

Prof. As. Dr. Gëzim Bisha, prej vitesh ushtron detyrën e Pedagogut pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit. I diplomuar në Gjeodezi, Prof. Bisha gëzon tituj të lartë akademik. Zgjidhet anëtar i kryesisë nga Asambleja e Përgjithshme. Është përfaqësues i pedagogjisë në SHGJSH. Prof. Gëzim Bisha është autor i një sërë li-brash dhe botimesh profesionale.

Rajmond Dervishi

Anëtar

Ka përfunduar studimet pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Dega Gjeodezi. Po në këtë Fakultet, ka kryer studimin Pas-Universitar mbi Vlerësimin e Pasurive të Paluajtshme. Z. Dervishi prej vitesh ushtron profesionin e Gjeodetit si në sektorin privat ashtu edhe në administratën shtetërore. Zgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme, anëtar i kryesisë së SHGJSH-së. Më pas, emërohet nga Kryetari i SHGJSH-së me detyrën Koordinator i Përgjithshëm.



Aderimi i Shoqatës së Gjeodetëve të Shqipërisë drejt strukturave dhe organizatave profesionale të Bashkimit European

The Council of European Geodetic Surveyors (CLGE)



Me ftesë të Këshillit të Gjeodetëve të Europës, konkretisht Presidentit të këtij Këshilli Z. Jean Yves Pirlot, Kryetari i Shoqatës së Gjeodetëve të Shqipërisë Z. Bledi Stefa merr pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të zhvilluar në Tallinn, Estoni. Z. Stefa shoqërohej së bashku me njërin prej anëtarëve i cili përfaqëson SHGJSH-në në Europë, Z. Julian Ismaili. Në këtë asamblë morën pjesë rreth 40 vende nga mbarë Europa por edhe jashtë saj. Fjala e hapjes së konferencës ju la Ministres së Mjedisit të Estonisë dhe më pas Presidenti i CLGE, Z. Jean Yves Pirlot si dhe Sekretarja e Përgjithshme Znj. Michelle Camilleri drejtuan konferencën deri në mbylljen e saj. Fjalimet dhe prezantimet ishin të shumta, qoftë në aspektin profesional ashtu edhe në këndvështimin social-kulturorë të shtrirjes së profesionit të Gjeodetit në mbarë Europën. Shoqata e Gjeodetëve të Shqipërisë pati në dispozicion një kohë të caktuar në të cilën, kryetari i saj Z. Bledi Stefa paraqiti tek të pranishmit larminë e ushtrimit të profesionit të Gjeodetit në Republikën e Shqipërisë. Ndër të tjera, ky prezantim, përveç anës profesionale pati edhe karakter patriotik në të cilin u përmendën avantazhet e këtij vendi kaq të bukur ku zhvillohej ky profesion por edhe bukuritë që Shqipëria ofron. Gjithashtu një pjesë e madhe e kohës u la mbi prezantimin dhe funksionimin e Shoqatës së Gjeodetëve të Shqipërisë, që nga themelimi i saj deri në ditët e sotme. Në prezantim u përmendën çështje të rëndësishme si ndërtimi i Albposit, pjesmarrja dhe realizimi i konferencave të ndryshme profesionale si dhe bashkëpunimi i krijuar midis SHGJSH, Shtetit Shqipëtar dhe Organizatave homologe.





European Group of Surveyors (EGoS)

Gjatë zhvillimit të Konferencës së Përgjithshme të Anëtarëve të SHGJSH-së e cila përkoi edhe me 20 vjetorin e themelimit të kësaj shoqate, morën pjesë të ftuar nderi Zëvendës Presidentja e Federatës Ndërkombëtare të Gjeodetëve me seli në Danimark, Znj. Chryssy Potsiou si dhe Sekretari i Përgjithshëm i Hellenic Association of Rural and Survey Engineers, Z. Nikolaos Zaxarias. Z. Zaxarias është njëherazi dhe Zëvendës President i Grupit Europian të Gjeodetëve. Pas mbarimit të këtij event, përshkruajtjet e të ftuarëve special ishin shume te mira. Gjatë kontakteve të mëvonëshme, SHGJSH merr një ftesë zyrtare nga Grupi Europian i Gjeodetëve për tu bërë pjesë e tij. Të gjithë anëtarët e këtij grupi profesionistësh janë përfaqësues të organizatave vendore në vendet respektive. Asambleja e Përgjithshme e EGoS zhvillohet çdo vit në vende të ndryshme të Europës. Asambleja e radhës ku mori pjesë Shoqata e Gjeodetëve të Shqipërisë, u zhvillua në Selanik. Konferenca ishte e planifikuar të mbahej në dy ditë. Ditën e parë asambleja e përgjithshme zhvilloi programin e saj, ndërsa ditën e dytë eventi mori përmasa edhe më të mëdha. Aty u paraqitën punime të ndryshme, u dhanë tituj nderi si dhe u ndanë certifikata të ndryshme për të pranishmit. Një ndër gjërat më pozitive që vlen të përmendet, gjatë pjesëmarrjes në këtë konferencë, ishte ftesa e bërë nga Kryetari i SHGJSH-së Z. Bledi Stefa, drejtuar Grupit Europian të Gjeodetëve dhe konkretisht Presidentit të EGoS-it Z. Randolph Camilleri, për zh-



villimin e Asamblesë së radhës në Republikën e Shqipërisë. Ftesa u mirëprit nga të gjithë të pranishmit dhe parimisht u vendos që në vitin 2012 EGoS do zhvillojë takimin e tyre të radhës në Tiranë. Kjo do të jetë një arritje shume e madhe, një ditë e vëçantë dhe historike për gjithë Gjeodezinë Shqipëtare. Pritet që në vitin 2012 Shqipërinë dhe Tiranën ta vizitojnë rreth 25 Gjeodet, përfaqësues nga vende të ndryshme të Europës.

GENT ALBA, Sh.p.k	Kostandin Qirjazi ing Gjeodet
Rr Ali Begeja .P.14.Nr 3 Tiranë Kod.Pos 1017	Mob: +355682056913 email: qirjazik @ yahoo.com
	.Project .Consulting .Survey .Construction .Supervising .Mapping

MARKAT

Rëndësia e përdorimit të tyre në sistemin e pronës private, publike si dhe rrjeteve inxhinierike

Prodhiimi dhe përdorimi i markave gjen vend dhe zbatueshmëri më të madhe, në Shtetet me të zhvilluara të Europës. Që në kohët e hershme, në vendin tonë përdorëshin shenja të dallueshme fizike për të bërë të mundur përcaktimin e kufijëve të tokave. Ato mund të ishin gurë të mëdhenjë të ngulur shumë pak mbi sipërfaqen fizike të tokës, apo kanale ujitëse të cilat përdoruesit e tokave i përdornin si shenja të dallueshme ndërmjet kufijëve të njëjës parcel me tjetrën. Për ndarjen e trojeve në qytete zakonisht, pika referimi janë muret egzistuese apo pemët deri tek rrjetat e telit të cilat shërbenin si orientim për kufijtë. Kjo eksperiencë ka sjell që jo në pak raste të kemi një problematik shumë të madhe në ndarjen dhe përcaktimin fizik të kufijëve. Plot ngjarje të tilla kanë rezultuar edhe me humbjen e jetës së personave që si burim është mos përcaktimi i saktë i kufirit të pronës dhe konfliktet që burojnë nga ky fakt.

Shumë shpesh ndodhë që të ngrihemi një mëngjes dhe të shikojmë murin e komshiut të spostuar një metër brënda pronës tonë apo një metër përpara pronës publike. Pra duke mos pasur një shenjë dalluese të ndarjes së kufijëve ndërmjet pronës publike dhe asaj private, gjithmonë tendeca e zaptimit do të egzistojë në % të lartë.

Ndodhë shpesh që gjatë punimeve për sistemimin e rrugëve të dëmtohet linja e ujësllësit apo e kanalizimeve të ndryshme dhe për këtë arsye derisa të evidentohet dhe zgjidhet problemi, duhet të rrimë disa ditë pa ujë në shtëpitë tona. E gjithë kjo vjen si mungesa e shenjave dalluese që në gjuhën teknike do të quhen Marka. Në pjesën e sipërme të markës krijohet hapsirë e nevojshme ku mund të stampohet emri i institucionit përgjegjës i cili bën administrimin e markave. Në momentin e kryerjes së një pune, nqs haset një markë e tillë, menjëherë duhet të njoftohet institucioni përgjegjës që ka në administrim markat.


Në tubacionet e rendesishme si gazi, uji, kanalizimet etj, markat absolutisht duhet të jenë të detyrueshme për tu vendosur. Me kalimin e viteve ato mund të kthehen në Pasuri Kombëtare pasi rëndësia që ato japin e bën më të sigurt realizimin e një pune të mirëfilltë teknike.

Shteti duhet të jetë promotor i këtij ndryshimi. Duhet të hartojë një ligj për implementimin dhe shtrirjen e tyre në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë i cili më pas mund të funksionojë nëpërmjet rregulloreve të ndryshme teknike. Markat mund të lidhen edhe me Rrjetin Shtetëror të Koordinatave. Që në këtë moment, mar-



kat janë të pozicionuar në sistemin koordinativ të pranuar dhe ato mund të verifikohen lehtësisht. Implementimi i tyre në sistemin e pronës do të sillte një rënie të ndjeshme të konflikteve lidhur me ndarjen faktike dhe fizike të pronës. Dy janë përfituesit me kryesor të implementimit të markave në Republikën e Shqipërisë, (qoftë për zonat urbane ashtu edhe për ato rurale):

1. **Individi**, pasi vendosja e markës në qoshet e pronës së tij do të bente të përhershëm, të pacënueshëm dhe të mirë administrueshëm kufijtë e parcelës së tij.
2. **Shteti**, i cili me vendosjen e markave do të bente ndarjen e pronës private me atë publike si dhe, do e ruante pronën publike nga fenomeni i zaptimeve.





Udhë të Mbarë Revistës së Re të Gjeodezisë

Të nderuar kolegë Gjeodetë,

Me gëzim e prita lajmin mbi përpjekjen e Shoqatës së Gjeodetëve të Shqipërisë për botimin e një reviste trajtuese të problemeve të profesionit të gjeodezisë dhe fushave të tjera lidhur me të, në vendin tonë. Sikurse mund ta dini, në periudhën 1994-1997, Shoqata e Gjeodetëve të Shqipërisë me përpjekjen e disa anëtarëve të saj dhe me ndihmën e konsiderueshme të Shoqatës simotër Zviceriane, arriti të botojë “Revistën Gjodezike” Shqiptare, e cila pushoi së botuari gjatë kaosit total që përfshiu gjithë vendin tonë gjatë vitit 1997. Nuk mund të lë në heshtje kontributin dhe përpjekjet e mëdha të grupit botues të revistës, e sidomos të të ndjerit Inxhinier Gjeodet Gjergji Qeleshi, i cili fatkeqësisht tashmë nuk jeton midis nesh. Si një ndër pjesëtarët e grupit botues të ish Revistës Gjeodezike, ju lutem lexuesve të revistës së re të kujtojnë përherë me respekt e konsideratë: Gjeodetin Iluministin Shqiptar, iniciuesin, realizuesin e asaj reviste, të ndjerin Ing. Gjergji Qeleshi. Efekti, apo dobia e ish “Revistës Gjeodezike” e cila dërgohej edhe në shumë vende të tjera të botës, në mos brenda vendit, jashtë tij pati një jehonë mjaft pozitive. Këtë jehonë pozitive e tregoi edhe dëshira e disa autorëve të huaj me zë, të cilët dërguan për botim artikuj të tyre, që u botuan në disa numra të asaj reviste. Mendoj se ridalja e revistës së re, do të gjallërojë jetën e aktivitetin tonë profesional në dobi të evidencimit dhe zgjidhjes së problemeve të shumta të këtij profesioni, të grumbulluara e të mbetura pa zgjidhje për shumë vite të mungesës së një organi të tillë mjaft të nevojshëm. Iu drejtohem veçanërisht brezit të ri të sotëm të Gjeodetëve ta përkrahin revistën e re e ta trajtojnë si një krijesë të dashur të tyre. Revistës së re i uroj kohëbotim të gjatë, liri rrahje mendimesh të lexuesve të saj dhe përkrahje të gjithëanëshme të anëtarëve të Shoqatës. I uroj vullnet e forcë për të mbrojtur interesat e profesionit dhe të komunitetit Gjeodezik, i cili po vjen duke u rritur konsiderueshëm në numur. I uroj po ashtu, revistës së re, formë e veçanërisht përmbajtje dinjitoze ashtu si simotrat e saj europiane e botërore. Udhë të gjatë e të mbarë revista jonë e re!

Qemal SKUKA,

Pedagog në Departamentin e Gjeodezisë, FIN, UPT, Tiranë

Nga Ing. Bledi Stefa

Ç'farë është ALBPOS?



Albanian Positioning Sistem

Albpos është sistemi që zëvendëson Rrjetin e Triangolacionit Shqipëtar. Për prodhimin e pothuajse të gjitha hartave të ndryshme, ne bazohemi në Rrjetin e Triangolacionit Shqipëtar. Ky rrjet është një sistem pikash me Koordinata të njohura të ndërtuara nga Instituti Gjeografik i Ushtrisë

shumë përpara viteve 90. Me kalimin e viteve si dhe për shkak të ndryshimeve që kanë ndodhur në Shqipëri, ky rrjet është dëmtuar ndjeshëm dhe pothuajse është bërë inegzistent. Në këto kushte lind nevoja e një sistemi të ri, të plotë dhe funksional i cili të ketë një saktësi të lartë në matje për ti dhënë zgjidhje shumë problemeve Gjeodezike. Realizimi i këtij sistemi u bë me ndihmën e Komunitetit Europian si dhe me mirëkuptimin dhe memorandumit e përbashkët të Zyres Qendrore të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Universitetit Politeknik të Tiranës (Departamenti i Gjeodezisë) dhe Institutit të Gjeografisë Ushtarake.

Ndërtimi i Sistemit

ALBPOS është një sistem VRS (Virtual Reference Station) dhe është i përbërë nga 16 stacione permanente GPS të cilat janë të vendosura në një

distancë 50-70 km. Stacionet masin në mënyrë të vazhdueshme pozicionin e tyre në (X,Y,Z). Stacionet janë të lidhura me një qendër kontrolli nëpërmjet linjave të internetit. Ato dërgojnë të dhënat e tyre në Qendrën e Kontrollit dhe kjo e fundit kontrollon funksionimin e stacioneve. Këto të dhëna ruhen në një Web SERVER. Përdoruesit me Marrës (GPS) logohen në këtë Web Server nëpërmjet GPRS (internet nëpërmjet telefonit celular) dhe dërgojnë të dhëna të përafërta të pozicionit të tyre. Qendra duke parë pozicionin e marrësit llogarit nga gjithë sistemi një stacion virtual (BAZA) në një pozicion rreth 10 m larg nga marrësi. Nga ky stacion virtual llogariten prerjet shumëfish nga mbrapa dhe i dërgohen marrësit i cili llogarit koordinatat përfundimtare (pozicionin) me saktësi 1-2cm.

Përfitimet e Stacioneve Referencë Permanente

- Reduktim i gabimive të mëdha
- Produktivitet më të lartë
- Siguri e lartë
- Reduktim në pajisje

Avantazhet e rrjetit VRS

- Pakëson gabimet sistematike
- Hapësirë e pakufizuar operimi me inicializim dhe saktësi të përmirësuar
- Produktivitet i lartë
- Eleminon nevojat për të vendosur stacione lokale lokale reference
- Siguron monitorimin e integritetit të sistemit.
- Siguron opsion alarmi
- Siguron një sistem në të gjithë vendin duke zgjidhur problemin e mbivendosjes
- Saktësi unike 1-2 cm në të gjithë rrjetin

Aplikimet aktuale

- Gjeomatika
- Monitorim i deformimeve
- Kërkime shkencore
- Topografi
- Konstruksion
- Pozicionim dhe marine
- Hartografim dhe GIS
- Navigim

Problemet që ka sistemi për momentin

- Zgjidhja e bazës ligjore të sistemit
- Përcaktimi përfundimtar i institucionit përfitues i cili mund të jetë:

Konsorciumi deri në pjekjen e kushteve dhe ndërgjegjesimin

e paleve të interesit.

Një nga anetarët e konsorciumit

- Përgatitja e planeve të funksionimit, buxheteve në mënyrë që sistemi të ketë vazhdimësi.
- Përmirësimi i vazhdueshëm i sistemit dhe plotësimi i tij me Geoidin Shqiptar i cili ka të njëjtat përmasa dhe rëndësi po aq sa aplikacioni i deritanishëm.
- Lidhja e sistemit apo shkëmbimi i informacioneve me rrjetet fqinje dhe atë europian.
- Rritja e numrit të aplikacioneve.
- Rritja e numrit të përdoruesve.



Fig. 1 Shpërndarja e stacioneve satelitore në gjithë sipërfaqen e vendit





Nga Alban Hasa, Sekretar i Përgjithshëm

Të gjithë i mbajnë sytë tek Shoqata e Gjeodetëve të Shqipërisë duke shpresuar që nëpërmjet saj mund të arrihet gjithçka. Si mundet, sa hap e mbyll sytë një grup i vogël (i madh) në një periudhë kohe kaq të shkurtër të arrijë të prek gjëra të cilat Gjeodetët prej vitesh nuk kanë mundur ti ndryshojnë. Por megjithë kësaj, si dhe vështirësive ekonomike me plotë krenari mund të thuhet se gurët e themeleve janë vendosur. Mjafton pak kontribut i gjithsecilit prej nesh, për të ndërtuar një strehë e cila do të mbrojë të gjithë Topografit dhe Gjeodetët Shqipëtar, qoftë në aspektin teknik, ekonomik por edhe në atë juridik. Problemet janë të shumta, që nga çmimet e punimeve e deri tek planet e rëlvimit. Përpjekjet e SHGJSH-së në të gjitha drejtimet kanë qënë të shumta. Ndër këto përpjekje, aktualisht mund të themi me plot gojë që umbrella e përbashkët me emrin "Shoqata e Gjeodetëve të Shqipërisë" ka mundur të krijojë një udhë drejt zhvillimit dhe përmirësimit të aktualitetit Gjeodezik. Jo se duam të krenohemi me arritjet që po rendisim pak më posht, por thjeshtë duam të sjellim në vëmendjen e çdo personi që ushtron profesionin e Gjeodetit apo Topografit, që duke kontribuar sado pak për interesat tona të përbashkëta, shumë herë më të lehta do të jenë sfidat tona profesionale, social-ekonomike, juridike etj. Në fillim të vitit 2010, fillon punën Kryesia e SHGJSH-së, nën drejtimin e Kryetarit, Z. Bledi Stefa. Me shumë përpjekje arrihen të mbahen mbledhje sporadike, duke diskutuar çështje konkrete problematike, aktivitete kulturore si dhe objektiva për të ardhmen. Vlen të përmendet Konferenca më e madhe Ballkanike e realizuar me ras-

tin e 20 vjetorit të themelimit të Shoqatës së Gjeodetëve të Shqipërisë. Në të morën pjesë përfaqësues të të gjitha trevave Shqipëtare, pedagogë, firma dhe kompani private, student, përfaqësues më të lartë të administratës shtetërore, gjeodetë të licencuar etj. Kjo konferencë pasoi me zhvillimin e një tjetër eventi i cili i përkiste Gjeodeteve të së Ardhmes ose siç njihet ndryshe Konferenca e Parë "Young Surveyors". Një një periudhë kaq të shkurtër u arritën të realizoheshin dy evente madhështore që përcohlën tek të gjithë në vlera të mëdha. Jo vetëm që doli në pah grupi jonë i interesit por u evidentua edhe rendesia e tij.

SHGJSH, hyri në dy marrveshje bashkëpunimi, me kompanitë private të instrumentave gjeodezike, si dhe me disa institucione shtetërore, për trajnimin e anëtarëve të saj. Vlen të përmendet, Kompania Geotrim Ltd, Geotech Sh.p.k, Zyra Rajonale e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë si dhe Arkivi Qëndror Teknik i Ndërtimit. Anëtarë të SHGJSH-së u njohën me procedurën e punës që zhvillonin këto institucione si dhe patën rastin të preknin teknologjinë më të avancuar, për saj ju përketë instrumentave gjeodezik. Në një kohë disa mujore u katërfishua numri i anëtarëve të SHGJSH-së si dhe, çdo anëtar u pajisë me kartën e anëtarësisë. Nga sa më sipër aktiviteti i SHGJSH-së hyri në një rrugë tjetër. Filluan të vijnë kërkesa për pjesmarrje në inisiativa ligjore konkrete, siç është përgatitja e projektiligjit për "Urdhërin e Inxhinierit", diskutimi mbi ndryshimin e Vendimin nr. 444, Datë. 05. 09. 1994, "Për Tarifat e Studimit, Projektimit, Drejtimin, dhe Kolaudimit të Veprave të Ndërtimit", hartimi i rregullores dhe procedurave për Provimin

e Shtetit, etj. U ngrite faqja zyrtare e SHGJSH-së në internet si dhe u krijua adresa zyrtare elektronike e saj. Pas realizimit të konferencës së parë "Gjeodetët e së Ardhmes, Young Surveyors" u ngritën grupe pune mbi problemet e kadastrës, punimeve të gjeodezisë inxhinierike, si dhe u krijua grupi i punës së studentëve të cilët do të paraqesin shqetësimet e tyre lidhur me programet mësimore.

Mbas gjithë këtij kalvari përpjekjesh dhe arritjesh, me referendumin e ndërrmarë, SHGJSH arriti të firmos nga një numër i konsiderueshëm anëtarësh, përcaktimin e datës 22 Janar, si Ditën e Gjeodetit. Ditë e cila do të jetë një trashëgimi e bukur për të gjithë brezat e së shkuarës, të së tashmes dhe të së ardhmes së Gjeodezisë Shqipëtare. Sfidat që e presin SHGJSH-në janë të shumta dhe kuptimplote. Ndër më kryesoret është botimi në mënyrë sistematike i Revistës Gjeodeti, e cila kërkon një mbështetje të gjithëanëshme, sidomos prej firmave Gjeodezike që operojnë në treg. Realizimi i konferencave dhe i seminareve të ndryshme, ku mund të trajtohen problematikat e shumta që gjeodeti has në punën e tij të përditëshme profesionale. Pjesmarrja në komisione të ndryshme si dhe bashkëpunimi me të gjitha strukturat shtetërore që hartojnë rregullore apo ligje, në shërbim të profesionit.

Aktualisht, SHGJSH gëzon një bashkëpunim të madh me shoqatat e ngjashme si brenda ashtu edhe jashtë vendit, por jo vetëm kaq. Bashkëpunim ajo ka gjetur edhe me shoqata të tjera të cilat përfshijnë fusha të ndryshme të ndërtimit. Gjeodetët Shqipëtar, tashmë janë pjesë e Federatës Ndërkombëtare (FIG) me seli në Danimark si dhe, janë bashkangjitur Grupit të Gjeodetëve (EGoS) dhe Këshillit të Gjeodetëve të Europës (CLGE).

Sfidat në aplikimin e gjeodezisë në ditët e sotme

Ing. Lorenc Zani

Msc. Adelajda Halili

** Autorët e shkrimit janë drejtues teknik të kompanisë Lorenzo & Co.*



Gjeodezia përpara viteve 90 ishte një nga shkencat së cilës i kushtohej një rëndësi e veçantë. Disa prej institucioneve të përfshira në fushën e gjeodezisë para viteve 90 në Shqipëri ishin:

- Instituti i Topografisë Ushtarake
- Instituti i Gjeodezi-Gjeologjisë
- Instituti i Tokave
- Instituti i Urbanistikës
- Instituti i Projektimit të Rrugëve
- Kadastrat e rretheve

Pas vitit 90 me ndërrimin e sistemeve, shoqëria shqiptare filloi të ndryshonte me hapa shumë të shpejtë në të gjitha dimensionet. Disa nga momentet me të rëndësishme të këtij ndryshimi ishin:

- Privatizimi i kapitaleve shtetërore (ndërmarrjeve shtetërore, tokës bujqësore)
- Levizja e lirë e popullsisë (ndryshimet urbane)
- Hapja e bizneseve private etj.

Ndryshimet u reflektuan dhe në fushën e gjeodezisë. Një pjesë e institucioneve gjeodezike u mbyllën ose u reformuan. Rrjeti i triangulacionit dhe nivelacionit shtetëror, që shërbente si bazë gjeodezike pothuajse doli jashtë funksionit. Në këtë tranzicion të zgjatur ka pasur dhe përpjekje pozitive të cilat mbështetën zhvillimin e gjeodezisë, të tilla si:

- Ngritja e sistemit të ri të regjistrimit të pronave jo vetëm mundësoi krijimin dhe lulëzimin e kompanive private gjeodezike por solli dhe aplikimin e teknologjisë së re në fushën e gjeodezisë;
- Ndërtimi i rrjetit të ri GPS (ALBPOS) zëvendësoi rrjetin e triangulacionit. Ky rrjet bazuar në teknologjinë më të fundit ofron saktësi shumë herë më të lartë;
- Përpjekjet e Qeverisë për themelimin e një institucioni i cili do të koordinojë gjithë punët gjeodezike.

Megjithë përpjekjet që janë bërë për zhvillimin e gjeodezisë, problematikat janë ende të pranishme. Baza gjeodezike si pjesë e infrastrukturës së një vendi, është një element shumë i rëndësishëm së cilës duhet ti kushtohet një vëmendje e veçantë. Mungesa apo pasaktësia e bazës gjeodezike ndikon në Planifikimin hapsinor si dhe pro-

jektimin e ndërtimit e infrastrukturës (rrugore, rrjeteve të ujësjesave e kanalizimeve apo vepra të tjera publike dhe private). Për këtë qëllim me iniciativën e Zyrës Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe në marrveshje me IGJU dhe Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit (Dep. Gjeodezisë), Komuniteti Europian duke vlerësuar rëndësinë e këtij problemi, akordoi një grant jo vetëm për ndërtimin e një sistemi të ri GPS (ALBPOS) por edhe për funksionimin për një vit të këtij sistemi. Gjatë kësaj periudhe një vjeçare të funksionimit institucionet përgjegjëse duhej të kishin përcaktuar kuadrin ligjor dhe buxhetin përkatës të funksionimit të mëtejshëm të këtij sistemi. Pavarsisht përpjekjeve, vonesat në vendim marrje po rrezikojnë që ky sistem të bëhet inekzistent. Gjithsesi ky sistem zgjidh një pjesë të Sistemit Gjeodezik Shqiptar, atë në plan. Që ky sistem të jetë i plotë duhet të zgjidh edhe problemin në lartësi. Zgjidhja e këtij problemi do të realizohet me formulimin e Gjeoidit Shqiptar dhe rindërtimin e rrjetit të nivelacionit. Hapa të menjëhershëm duhet të ndërmerren në mënyrë që kjo bazë gjeodezike të jetë funksionale. Investimet që duhen të bëhen janë pothuajse të papërfillshme për një shtet (të rangut të disa milionave euro), ndërkohë që rëndësia e tij është shumë herë më e madhe dhe e padiskutueshme. Ndodh shpesh që projekte të ndryshme me rëndësi kombëtare ose lokale, nga institucione shtetërore apo komunale (Drejtoria e Rrugëve, Ujësjiellës-Kanalizimeve, bashkitë, komunat) nuk kanë një referencë koordinatash të lidhura me sistemin shtetëror të koordinatave. Kjo sjell jo vetëm problemet që kanë të bëjnë me cilësinë e jetës por edhe me probleme madhore sic janë përmytjet, problemet me mbivendosjet e pronave etj. Përdorimi i këtij sistemi (ALBPOS) si baza gjeodezike shqiptare duhet të jetë standart i detyrueshëm kombëtar për të gjithë. Një pjesë e rëndësishme është edhe zhvillimi i mëtejshëm dhe kontrolli për zbatimin e standarteve. Ashtu si edhe në fushat e tjera, standartet kombëtare duhet të përafrohen dhe përshtaten më tej me ato të KE. Pjesë e rëndësishme për zhvillimin e standarteve është koordinimi i institucioneve të cilat kanë shërbimin gjeodezik pjesë të tyre. Një pjesë e rëndësishme e përmirësimit të shërbimit gjeodezik është edhe inkurajimi i kompanive private. Në rajon dhe në botë kompanitë gjeodezike subvencionohen nga shteti duke ju dhënë punë të vazhdueshme ose minimalisht

duke mundësuar bashkëpunimin me kompani të huaja në nivele të barabarta, heqjen e TVSH për teknologjinë e re që futet si dhe lehtësira të tjera. Gjithashtu, po aq e rëndësishme për kompanitë private është edhe zhdukja e tregut informal. Individë të licensuar ose jo marrin përsipër kryerjen e punimeve gjeodezike në “të zezë”. Pasojat e këtij tregu informal janë ndër të tjera edhe evazioni fiskal nga mosmbledja e tatimeve, prishja e tregut për kompanitë private dhe shpesh falimentimi i tyre si dhe mosrespektimi i standarteve teknike. Nga ana e institucioneve shtetërore kërkohet një kontroll më i rreptë në lidhje me:

- Stafin gjeodezik apo instrumentat e përdorur nga kompanitë e projektimit apo të zbatimit (duke mos u mjaftuar thjeshtë me ekzistencën e një license për punimet gjeodezike), ndarjen e këtij shërbimi dhe kontraktimin direkt të firmave gjeodezike.
- Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme të kërkohet jo thjesht fotokopje e Hartës së Regjistrimit por mbështetja në sistemin gjeodezik shqiptar, koordinata të kulmeve të parcelës (në mënyrë që të shmangen mbivendosjet), faturën e kasës fiskale etj.

Zhvillimi apo aplikimi i shkencës së gjeodezisë lidhet edhe me edukimin dhe përgatitjen e brezit të ri të gjeodetëve. Cilësia e Universitetet shtetërore apo private është shumë e rëndësishme në këtë drejtim. Përveç rishikimit të programeve mësimore, që po i përshtaten teknologjisë bashkëkohore, një rol të rëndësishëm kanë dhe orët praktike. Profesioni i gjeodetit lidhet ngushtë me përdorimin e instrumentave dhe programeve të ndryshme përpunuese. Pothuajse të gjitha katedrat nuk kanë laboratore për gjeodezinë ose laboratorët ekzistues nuk janë bashkëkohore. Për rrjedhojë mësimi është teorik, specialistët e rinj nuk marrin njohuritë e para praktike të profesionit dhe rrjedhimisht ndihet mungesa në treg e specialistëve dinjitozë. Shoqata e Gjeodetëve duhet të jetë aktive për të përkrahur komunitetin e gjeodetëve, që zëri i gjeodetit të dëgjohet nga të gjithë. Në këto 20 vjet tranzicion, janë bërë përpjekje të herëpashershme për funksionimin e Shoqatës së Gjeodetëve. Këto përpjekje në pjesën më të madhe kanë rezultuar jo të sukseshme apo të pamjaftueshme. Shpresojmë që riaktivizimi i Shoqatës dhe përpjekjet që po bëhen të japin rezultatet e duhura.



Complementarity, Reliability, Innovation and International Experience to serve specific needs for a large spectrum of applications:

- **Cadastre - Surveying**
- **Geo - information data compilation & processing - Cartography**
- **Integrated Geo - Informatics Systems**
- **Thematic Applications (Agriculture, Forestry, Environment, Risk Management, Urban Planning, etc)**
- **Infrastructure Works**

YOUR PARTNER for EFFICIENCY!!

Contact Details

Athens

Tel +30 210-6980158, 9

Fax +30 210-6980686

www.geoapikonisis.gr

Thessaloniki

Tel +30 2310 496800

Fax +30 2310 496880

www.geoanalysis.gr

Shoqëria “Geo -Sky” shpk **Administratori** **Edison Sinanaj**



Shoqëria “Geo-Sky” Sh.p.k. është themeluar me Vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë No. 33028 datë 23. 02. 2005. Aktualisht mban Liçensën Profesionale për Projektim dhe Zbatim për të gjithë zërat e parashikuar nga Komisioni i Dhënies së Liçensave Profesionale. Me liçensë profesionale janë të pajisur dhe stafi drejtues i firmës. Gjatë kësaj periudhe “Geo-Sky” sh.p.k. ka ushtruar aktivitetet të gjerë dhe cilësor në projektimin dhe zbatimin e punimeve topografike, gjeodezike dhe hartografike në disa fusha si në kadastrim, ndërtim, në projektim rrugësh dhe ujësjellësash, etj. Per nje kohe te gjate specialistet e Shoqerise jane angazhuar pranë Njesisë së Menazhimit të Projektit për Sistemin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, për azhurnimin, rilevimin dhe përgatitjen e hartave treguese të pasurive të paluajtshme. Për kryerjen e punimeve rilevuese në zonat urbane të fshatrave dhe qyteteve kemi projektuar dhe zbatuar rrjete mbështetës gjeodezike, që plotësojnë kërkesat e shkallëve 1:500 dhe 1:1000. Stafi drejtues i shoqërisë “Geo-Sky” sh.p.k. ka një eksperiencë pune mbi 30 vjeçare në punimet topografike

dhe gjeodezike, hartografike dhe fotogrametrike. Ai është pjesëmarrës aktiv në rilevime të shkallëve të ndryshme nga 1:500 deri 1:25000, në hartografin e territorit të vendit me metoda fotogrametrike (fotografi ajrore), në projektimin dhe zbatimin e Triangolacionit dhe Nivelimit shtetëror të Klasës I, II, dhe III, në punime markshejderike, ndërtim hekurudhash, në punimet gjeodezike për projektim rrugësh, të ujësjellësave, etj. Specialistet kane marrë pjesë drejtpërdrejtë në hartimin e disa projekteve me rendesi Kombetare, gjithashtu kane qene pjese ne kryerjen e punimeve topogjeodezike për projektimin e teleferikut Tiranë - Dajt etj. Me porosi të kompanive të mëdha të celularëve Vodafone dhe AMC specialistet e Shoqerise kane kryer punime topogjeodezike për projektim të rrugëve, dhe objekteve per ndertimin e antenave ne qytete te ndryshme te Shqiperise. Gjate viteve 2005-2010, Shoqeria eshte angazhuar ne rilevimet topografike te cilat jane perdorur per studime urbanistike, si dhe per projektimin e objekteve te ndertimit si komplekse banimi dhe objekte industriale. Gjithashtu

specialistet e shoqerise kane punuar dhe ne zbatimin e punimeve. Gjate viteve 2006 - 2009 Shoqeria eshte angazhuar ne kryerjen e punimeve topografike ne interes te projektimit te rrugeve rurale ne disa Qarqe. Nje angazhim te vecante Shoqeria ka treguar ne Hidrocentralin e Sabinjes ne Rrethin e Pogradecit. Per te siguruar zbatimin e punimeve nga Shoqeria eshte pergatitur nje rrjet gjeodezik i cili perfshin tere zonen e punimeve dhe nje tjeter rrjet Gjeodezik brenda te parit i cili siguron kryerjen e punimeve per hapjen e tunelit prej 2 km. Një nga arritjet kryesore të shoqërisë është dixhitalizimi i punimeve topografike dhe gjeodezike. Shoqëria ka investuar dhe zotëron një potencial modern pajisjesh profesionale, si GPS, Total Station, kompjutera, softe speciale, etj, të cilat i lejojnë stafit të përdorë teknologjitë bashkëkohore të punimeve topogjeodezike. Në aktivitetin tonë kemi zbatuar rigorozisht ligjet dhe udhëzimet, kontratat dhe detyrimet fiskale. Nuk kemi patur asnjë reklamim në punë dhe asnjë masë ligjore apo administrative nga organet shtetërore të kontrollit.

SARA sh.p.k

Data e rregjistrimit 04/07/1997

Administrator dhe Drejtor Ligjor, Besnik Hysaj
Drejtnik Teknik, Ing. Shahin Okaj



Themelimi i Shoqerise ishte fryt i nje bashkpunimi te gjate mes kolegeve dhe eksperiencave te fituara ngapunimet te ndryshme inxhinjerike. Kompania Sara ushtron aktivitetin

e saj ne punimet topogjeodezike ne objektet inxhenjerike, punime speciale gjeodezike, punime fotogrametrike, bazamente gjeodezike per rilevimet ne te gjitha shkallet, ndertim rruge

kategori IV,V, punime te mirmajtjes, sinjalizimit dhe te vijzimit ne rruge, ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, etj. Zoterojme instrumenta gjeodezike si; Total Station, GPS,



Nivela, Kompjutera, Transportier etj.

Kompania jone ka kryer punime mbi regjistrimin fillestar te pasurive te paluajtshme, ujesjellesa, kanalizime, rruge, rilevime topografike, ne disa qytete dhe fshatra te Shqiperise. Sara & Company gjate punes ka patur nje bashkepunim me firmat e tjera te specializuara per punime te ndryshme topografike si ne projektim ashtu edhe ne zbatim, per rruge, rilevime topografike te shkallave te ndryshme, studime urbanistike, kanale, ujesjellesa, nivelime etj. Ne vartesi te fluksit te punes Kompania Sara bashkepunon me nje numer te madh Inxhinieresh dhe Topografesh, me qellim realizimin e nje pune cilesore dhe profesionale.

Fjala e Presidentit të Këshillit të Gjeodetëve të Europës

Z. Jean-Yves Pirlot, drejtuar SHGJSH-së

**Dear Albanian Surveyors,
Dear Colleagues and Friends,**

It's a pleasure for me to introduce this new professional magazine, published by our young Albanian Member Organisation "Albania Association of Geodesy", under the presidency of Bledi Stefa. The European Council of Geodetic Surveyors unites more than 50.000 surveyors, in 35 countries spread all over Europe. We are proud and happy that during our last General Assembly in Tallinn, on September 16th 2011, your Union became part of us. We all know that the Surveyor plays an essential role in our societies. This is particularly true during these very troubled days.

We are literally building the Geographic Infrastructure of Europe with our land delimitation duties and our tasks in the field of GeoInformation gathering and management. Albania has a strong potential for growth. Especially in such circumstances, Surveyors are – or should be – very demanded professionals. It is clear too that these crucial tasks require well trained people, sharing best practices and following sound Continued Professional Development courses (CPD). Therefore a very well organised and efficient professional association is an absolute must. I am convinced that AAG is on the good track and CLGE is committed to help your association keeping up with the ambitious goals just set out. We are willing to support you in the legal, economical and technical fields as requested by your president, Bledi Stefa, during his first address to our General Assembly.

There's a lot to do! Let us waste no time.

Yours Sincerely,

Jean-Yves Pirlot

CLGE President

www.clge.eu

jean-yves.pirlot@clge.eu

Twitter CLGEPresident



ÇMIMET E PUNIMEVE TOPOGRAFIKE NE ZBATIMIN E NDERTIMIT

1. Piketim per germimin e ndertimit 30 leke per m2
2. Piketim nivelim themeli per objekt ndertimi 100 leke per m2
3. Piketim nivelim kati 60 leke per m2
4. Piketim per sistemimin 30 leke m2
5. Piketimi i rruges provizore (Tabani i germimit) 60 leke ml
6. Piketim kanalizime K.U.Z. 100 leke ml
7. Piketim kanalizime te ujrave te shiut 100 leke ml
8. Piketim trotuare me te gjithë elementet 100 leke ml
9. Piketim ujesjellesi 30 leke ml
10. Piketim rruge me te gjithë elementet sipas projektit 50 leke m2
11. Saktesim kufi pronesie dhe pergatitje e Gen Planit me sip deri ne 1dy 10000 leke per pasuri

RILEVIMET TOPOGRAFIKE PER PROJEKT ZBATIMI NDERTIMI BANESA

1. Per parcela deri ne 1000 m2 rilevim per planet e shkalleve 1: 200,500,=60 leke m2
2. Per parcela nga 1000 m2 deri 2000 m2 rilevim per planet e shkalleve 1:500,1000=40 leke m2
3. Per parcela nga 2000 m2 deri 5000 m2 rilevim per planet e shkalleve 1: 500~1000=30 leke m2
4. Per parcela nga 5000 m2 deri ne 10000 m2 rilevim per shkallen 1:1000 =20 leke m2

RILEVIMET TOPOGRAFIKE PER PROJEKT ZBATIMI RRUGE DHE KUZ

1. Rilevime topografike per rruge rurale me brez rilevimi 25-30 m cmimi 75000 leke km
2. Rilevime topografike per rruge rurale me brez rilevimi 50-60 m cmimi 100000 leke km
3. Rilevime topografike per rruge urbane me brez rilevimi 25-30 m cmimi 120000 leke km
4. Rilevime topografike per rruge urbane me brez rilevimi 50~60 m cmimi 200000 leke km
5. Rilevim topografik per rruge Inter urbane me brez rilevimi 100~200m cmimi 25000 leke ha



Shoqata e Gjeodeteve të Shqipërisë prej datës 8 qershor 2010 është bërë pjesë e Federatës Ndërkombëtare të Gjeodeteve “FIG” me seli në Danimark. Ndërmjet SHGJSH-së dhe FIG egzistojnë marrdhënie shumë të mira në shkëmbimin e eksperiencave profesionale, literaturës, aktiviteteve etj.

Studio Topografike "GEOMATICA" Sh.p.k

Shoqëri e specializuar për punime topografike të një cilësie të lartë

Shërbimet që ofron Geomatica:

- Ndërtim bazamentesh gjeodezike
- Rilevime për studime urbanistike
- Plane rilevimi për pronat
- Planimetri dhe profilime , të rrugëve, ujësjellësve etj
- Punime GIS
- Dixhitalizime të ndryshme
- Rilevime gjeologjike dhe batimetrike
- Piketime në ç'do lloj ndërtimi
- Etj

Studio Topografike "GEOMATICA" Sh.p.k punon me një larmi instrumentash të teknologjisë së fundit si; Total Station, Nivela elektronike, distomatësa, instrument për vertikalitet në objekte të larta etj. Gjithashtu, ka në pronësi mjete të sigurta transporti dhe paisje zyrash si Laptop, printera, ploter etj.



Studio Topografike
"GEOMATICA"

sh.p.k.

mobil:+355(0)69 20 733 92

e-mail: jaksuli@yahoo.com

geomatica1996@yahoo.com

tel,fax:+355(0)42 26 15 69

Studio Topografike "Bylis"

Studio Topografike "Bylis" funksion qe nga viti 2007 duke iu sherbyer mbi 7000 klienteve ne Tirane dhe ne gjithe territorin Shqiptar. Studioja udhëhiqet nga ekspert Gjeodet Gjergj Begaj i cili ka kryer studimet ne fushen e topografise dhe hartografise. Qe prej kater vitesh studioja jone bashkepunon me Zyren e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme ne Tirane dhe gezon respektin e mijerave klienteve.



Sherbimet qe ofrojme

- Rilevime topografike pa limit
- Studime topografike inxhinierike
- Studimet teknike per pronat
- Plane Rilevimi
- Planimetri
- Ekspertiza Teknike Topografike
- Projekte civile industrial

Kontakt:

Rr."Jordan Misja", perballe Hipotekes

1001 Tirana, Albania

Tel.: +355 2 2403101

Fax: +355 2 2403101

Cel.: +355 69 40 93431

E-mail: info@bylis-imobiliare.com

Web: www.bylis-imobiliare.com

Per nje informacion me te sakt mund klikoni ne www.vetemprona.com



Studio Topografike "BYLIS"

o Rilevime o Plan vendosje o Konsulence
www.bylis-imobiliare.com e-mail: info@bylis-imobiliare.com

Tel./Fax: 04 24 03 101
04 22 70 207
Mob.: 069 4093431

Adresa:
1-Rr.Jordan Misja, Perballe Hipotekes
2-Ne unaze, kryqezimi burgut,
Tirane-Albania



Lorenzo & Co është themeluar në vitin 1996 si rezultat i një bashkëpunimi afatgjatë ndërmjet disa kolegëve, tek të cilët kombinoreshin përvoja të ndryshme në fushën e inxhinierisë civile.

Me dëshirën e mirë për t'iu përshtatur zhvillimeve të kohës, Lorenzo & Co investoi dhe vazhdon të investojë për futjen e teknologjisë më të re për realizimin sa më cilësor të punëve të cilat ka marrë përsipër.

Stafi i kompanisë, duke kombinuar përvojën e vjetër dhe atë të përfutur gjatë këtyre viteve si dhe teknologjinë bashkëkohore, është në gjendje të realizojë punime që janë vlerësuar si nga pikëpamja cilësore ashtu edhe koha e realizimit.




ashtech

Lorenzo & Co është përfaqësues i autorizuar për Shqipërinë dhe Kosovën i Ashtech, një prej kompanive lider në fushën e instrumenteve gjeodezike.



Në të gjithë veprimtarinë e tij, Lorenzo & Co operon me një vëmendje të veçantë ndaj komunitetit, shoqërisë dhe mjedisit.



Fushat e ekspertizës së kompanisë përfshijnë:

- Hartimin e relieveve topografike, kadastrale dhe gjeodezike të të gjitha llojeve;
- Aplikimet Mapping & GIS;
- Regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive të paluajtshme;
- Realizimin e analizave hapësinore dhe planifikimeve urbane;
- Projektimin dhe supervizionin në fushat e inxhinierisë civile (rugë, kanale, diga, rezervuare, furnizimet me ujë, tunele, ura, etj.);
- Trainime dhe ritje kapacite-tesh në fushat e hartografisë, topografisë, GIS, regjistrimi dhe menaxhimi i pasurive të paluajtshme si dhe shumë shërbime të tjera të fushës;




Në vitin 2009, Lorenzo & Co mori çertifikatën ISO 9001:2008



In 2009, Lorenzo & Co obtained the ISO 9001:2008 Certificate.



Lorenzo & Co is the authorized dealer for Albania and Kosovo of Ashtech, one of the world leading companies in the field of surveying instruments and software.



The foundation of Lorenzo & Co in 1996 was the distillate of matured collaboration amongst some colleague engineers with diverse experiences and know-how in engineering fields.

The vision and pursuits of the Company are to consistently invest in 'state-of-the-art' high technology instruments, equipment and software, in the recruitment and continuous development of high quality human resources and in the establishment of strong associations and synergies, in order to fulfill in the optimum way the engineering projects that it undertakes.

By meticulous blending of our rich experiences with contemporary technology and high professional ethics and standards, our staff is able to provide our clients with results, solutions and services of high quality and within agreed time schedules.

Lorenzo & Co operates with a high sensitivity for People, Society and the Environment.

Company's area of expertise includes but are not limited to the following:

- Geodetic and cadastral surveying works of all areas and categories;
- Mapping & GIS Applications;
- Real Estate Registration & Evaluation;
- Spatial Analyses and Urban Planning;
- Designing and Supervision in the area of Civil Engineering including (Highways, Drainage and Irrigation Channel, Dams and Reservoirs, Water and Sewage Systems, Tunnels, Bridges etc);
- Training and capacity building in areas of mapping, surveying, GIS, property registration and management;

ashtech

GRX1
GNSS Receiver

PLOTËSISHT I INTEGRUAR

Marrësi GNSS i vogël, kompakt & peshë e lehtë



Përfatime pa fund me GRX1.

Ju mund të merri 2 Rover, duke shmangur investimin e "kotë" për një bazë. GRX1 ju jep mundësinë që ju të filloni punë me ALBPOS (2 Rover) edhe kur ALBPOS nuk është funksional, me shumë lehtësi ju kaloni në lidhjen Bazë-Rover, thjesht duke zgjedhur opsionet "disconnect ALBPOS" dhe "connect Base-Rover". E gjithë kjo realizohet në terren, pa patur nevojë për ndonjë konfigurim në zyrë. Sot, GRX1 është i vetmi GPS që ju ofron një mundësi të tillë. Pra, GRX1 është investim i sigurt.

**Precision &
Reliability**

SOKKIA